



## **Kosova DemokratikTurk Partisi ( KDTP)**

**Raportet financiare të fushatës dhe Raporti i Auditorëve të pavarur**

**Zgjedhjet e Jashtëzakonshme Nacionale  
11 Maj 2017 – 11 Qershor 2017**



Përmbajtja:

Raport i auditorëve të Pavarur.. .....	3
Pasqyra e Pozitës Financiare.....	6
Pasqyra e te Hyrave dhe Shpenzimeve.....	7
Shënimet e pasqyrave financiare.....	8-10



# Raport i Auditorëve te pavarur

Drejtuar Kryesisë se Kosova Demokratik Turk Partisi

## Raport mbi Pasqyrat Financiare për qëllime specifike

### Opinion i kualifikuar

Ne kemi audituar raportet financiare të bashkëngjitura të Subjektit Politik Kosova Demokratik Turk Partisi (në vijim referuar si "Subjekti Politik" apo "KDTP"), te përbëra nga Pasqyra e Pozitës Financiare me 11 Qershori 2017, Pasqyra e te Hyrave dhe Shpenzimeve për periudhën 11 Maj 2017 – 11 Qershori 2017, dhe informacionin tjetër shpjegues të përfshira ne faqe 6-10.

Sipas mendimit tonë, me përjashtim të efekteve të çështjeve të pëershkuara në seksionin e Bazës për Opinionin te kualifikuar të rapportit tonë, pasqyrat financiare të bashkangjitura paraqesin drejt, në të gjitha aspektet materiale, pozicionin financier të subjektit Politik me datën 11 Qershori 2017, dhe të hyrat dhe shpenzimet për periudhen 11 Maj 2017 deri 11 Qershori 2017, në pajtim me Ligjin Nr. 03/L-174 Për financimin e subjekteve politike dhe me Ligjin Nr. 04/L-212 Për plotësimin dhe ndryshimin e Ligjit Nr. 03/L-174 Për financimin e subjekteve politike, të ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr.04/L-058

### Bazat për opinion të kualifikuar

- Subjekti Politik ka prezantuar, në Pasqyrë e të hyrave dhe shpenzimeve , donacione te pranuara përmes arke ne vlerë 5,900.00 ,EUR ne kundërshtim me ligjin Nr. 04/L-212 Për plotësimin dhe ndryshimin e Ligjit Nr. 03/L-174 Për financimin e subjekteve politike, të ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr.04/L-058, nen 4 Burimet financiare dhe materiale, paragrafi 4 i cili lejon pranimin e donacioneve ne te holla vetëm përmes llogarisë bankare.
- Ashtu siç është shpalosur në shënimin 2 të pasqyrës se të hyrave dhe shpenzimeve në zërin "pagat dhe kompenzimet" në vlerë bruto prej 3,040.00 Euro. Subjekti Politik ka angazhuar gjat fushatës nationale vëzhgues të qertifikuar dhe për shërbimet e kryera janë paguar në vlerë neto por që nuk janë mbajtur në burim dhe deklaruar kontributet pensionale të parapara sipas nenit 38 pika 1 e Ligjit mbi të Ardhurat Personale Nr.05/L -028. Po ashtu, duke pas parasysh natyren e shenimeve qe mban Subjekti Politik, dhe ne mungese te dokumentacionit mbeshtetes ne nuk ishim ne gjendje, duke aplikuar procedurat standarde dhe alternative te auditimit, te marrim siguri te arsyeshme qe shpenzimet ne vlerë 3,040 EUR kan ndodhur dhe i perkasin periudhes raportuese.

Ne kemi kryer auditimin tonë në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit (SNA). Përgjegjësitë tona sipas këtyre standardeve janë pëershkuar më tej në Përgjegjësitë e Auditorit ne paragrafin për Auditimin e Pasqyrave Financiare të rapportit tonë. Ne jemi të pavarur nga Shoqëria në përputhje me Kodin e Etikës për Profesionistet Kontabël të Bordit të Standardeve Ndërkombëtare të Etikës për Profesionistet Kontabël (Kodi i BSNEPK) së bashku me kërkasat etike që janë të zbatueshme për auditimin e pasqyrave financiare në Kosovë, dhe ne kemi përbushur përgjegjësitë tona të tjera etike në përputhje me këto kërkesa dhe Kodit IESBA. Ne



besojmë se evidenca e auditimit që ne kemi marrë është e mjaftueshme dhe e përshtatshme për të dhënë bazat për opinionin tonë.

### Theksim i çështjes

Pa e kualifikuar opinionin ton, ne tërheqim vëmendjen në lidhje me gjetjet e mëposhtme:

- Subjekti Politik nuk ka mirëmbajtur një kontabilitet te mirëfilltë për ti mundësuar regjistrimin e transaksioneve financiare dhe përgatitjen e pasqyrave financiare sipas Standardeve të Kontabilitetit të aplikueshme në Kosovë.
- Subjekti Politik ne blerjet e kryera nuk ka aplikuar ndonjë procedure te tenderimit e cila do te mundësonë një shfrytëzim sa më efikas, me kosto ekonomike, transparente dhe të drejtë të fondeve të subjektit politik.
- Subjekti Politik nuk e ka te definuar me Statut, mundësinë e ushtrimit të kontrollit të brendshëm financier të saj dhe të drejtën e anëtarëve për t'u informuar për të gjitha të hyrat dhe shpenzimet e subjekteve politike si dhe për përgjegjësinë e organit gjegjës për transaksione financiare, ashtu siç parashihet ne ligjin Nr. 04/L-212 Për plotësimin dhe ndryshimin e Ligjit Nr. 03/L-174 Për financimin e subjekteve politike, të ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr.04/L-058, neni 17 Kontrolli i Brendshëm.
- Subjekti Politik nuk ka respektuar kërkesat ligjore ne lidhje me publikimin e raporteve financiare vjetore dhe te fushatës sipas ligjit Nr. 04/L-212 Për plotësimin dhe ndryshimin e Ligjit Nr. 03/L-174 Për financimin e subjekteve politike, të ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr.04/L-058, neni 15 Raportimi Financiar, paragrafi 5.1 dhe 5.2.
- Gjatë auditimit tone ne kemi vërejtur qe te shpenzimet e reprezentacionit dhe karburantit, ne shumicën e rasteve SP nuk ka dokumentacionin relevant mbështetës, përvëç faturave, qe do munde te arsyetonin dhe mbështetnin shpenzimin e ndodhur.

### Përgjegjësia e drejtuesve dhe e atyre te ngarkuar me udheheqjen e SP për Pasqyrat Financiare

Drejtuesit e Subjektit politik jane përgjegjës për përgatitjen dhe paraqitjen e drejtë të këtyre pasqyrave financiare në përputhje me Ligjin Nr. 04/L-212 Për plotësimin dhe ndryshimin e Ligjit Nr. 03/L-174 Për financimin e subjekteve politike, të ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr.04/L-058 dhe për ato kontolle të brendshme që drejtimi i i gjykon të nevojshme për të bërë të mundur përgatitjen e pasqyrave financiare që nuk përbajnjë anomali materiale, qoftë për shkak të mashtrimit apo gabimit.

Në përgatitjen e pasqyrave financiare, drejtimi është përgjegjës për vlerësimin e aftësisë së subjektit politik për të vazduar aktivitetin e saj(parimi i vijimësisë), shpalosjen, sipas rastit, te çështjeve që lidhen me parimin e vijimësisë dhe përdorimin bazës se kontabilitet sipas parimit të vijimësisë përvëç nëse drejtimi synon të likuidojë Subjektin Politik ose të ndërpresë operacionet, ose nuk ka asnjë alternativë realiste përvëç për ta bërë këtë.

Ata që janë të ngarkuar me qeverisje janë përgjegjës për mbikëqyrjen e procesit të raportimit financiar të SP-së.

### Përgjegjësitë e auditorit për auditimin e Pasqyrave Financiare

Objektivat tona janë për të marrë siguri të arsyeshme nëse pasqyrat financiare si tërësi janë pa anomali materiale të shkaktuara nga mashtrimi apo gabimi, dhe për të nxjerrë raportin e një auditorit që përfshin opinionin tonë. Siguria e arsyeshme është një siguri e nivelit të lartë, por nuk



është një garanci që një auditim i kryer sipas SNA-ve do të identifikojë gjithmonë një anomali materiale kur ajo ekziston.

Anomalitë mund të vijnë si rezultat i gabimit ose i mashtrimit dhe konsiderohen materiale nëse, individualisht ose të marra së bashku, pritet që në mënyrë të arsyeshme, të influencojnë vendimet ekonomike të përdoruesve, të marra bazuar në këto pasqyra financiare.

Si pjesë e auditimit në përputhje me SNA-të, ne ushtrojmë gjykimin profesional dhe ruajmë skepticizmin profesional gjatë gjithë auditimit. Ne gjithashtu:

- Identifikojmë dhe vlerësojmë rreziqet e anomalisë materiale, qoftë për shkak të mashtrimit ose gabimit, hartojmë dhe kryejmë procedurat e auditimit në përgjigje të këtyre rreziqeve, dhe marrim evidencë auditimi që është e mjaftueshme dhe e përshtatshme për të siguruar një bazë për opinionin tonë. Rreziku i mosbulimit të një anomali materiale si rezultat i mashtrimit është më i lartë se rreziku si rezultat i gabimit, sepse mashtrimi mund të përfshijë marrëveshje të fshehta, falsifikime, përjashtime të qëllimshme, informacione të deformuara, anashkalime të kontrolleve të brendshme.
- Sigurojmë një njojje të kontrollit të brendshëm që ka të bëjë me auditimin, me qëllim që të përcaktojmë procedurat e auditimit që janë të përshtatshme sipas rrëthanave, por jo për qëllime të shprehjes së një opioni mbi efikasitetin e kontrollit të brendshëm të Shoqërisë.
- Vlerësojmë përshtatshmërinë e politikave kontabël të përdorura dhe arsyeshmërinë e çmuarjeve kontabël dhe të shpjegimeve përkatëse të bëra nga drejtimi.
- Nxjerrim një konkluzion në lidhje me përshtatshmërinë e përdorimit të bazës kontabël të vijimësisë, dhe bazuar në evidencën e auditimit të marrë, nëse ka një pasiguri materiale në lidhje me ngjarjet ose kushtet, e cila mund të hedhë dyshime të mëdha për aftësinë e Shoqërisë për të vjuar veprimtarinë. Nëse ne arrijmë në përfundimin që ka një pasiguri ne duhet të térheqim vëmendjen në raportin e audituesit në lidhje me shpjegimet e dhëna në pasqyrat financiare, ose nëse këto shpjegime janë të papërshtatshme, duhet të modifikojmë opinionin tonë. Konkluzionet tona bazohen në evidencën e auditimit të marrë deri në datën e raportit tonë. Megjithatë, ngjarje ose kushte të ardhshme mund të bëjnë që Shoqëria të ndërpresë veprimtarinë.

Ne komunikojmë me personat e ngarkuar me qeverisjen, përveç të tjerave, lidhur me qëllimin dhe kohën e auditimit dhe gjetjet e rëndësishme të auditimit, përfshirë ndonjë mangësi të rëndësishme në kontrollin e brendshëm që ne mund të identifikojmë gjatë auditimit.

Audit & Conto sh.p.k

Ymer Shatri  
Auditor ligjor  
12.04.2019



**Kosova Demokratik Turk Partisi**

*Pasqyrat Financiare te Fushatës*

*Zgjedhjet e jashtëzakonshme nacionale 11 Maj 2017 deri me 11 Qershor 2017*

<b>Pasqyra e Pozitës Financiare</b>		<b>Bilanci ne fund te periudhes</b>	<b>Bilanci ne fillim te periudhes</b>
<b>Pasuritë</b>	<b>Shënim</b>	<b>Shuma në Euro</b>	<b>Shuma në Euro</b>
Pasuritë afatgjata			
Toka, objektet dhe pajisjet	2		
Pasuritë e paprekshme			
Pasuritë tjera afatgjata			
<b>Total pasuritë afatgjata</b>		<b>0.00</b>	<b>0.00</b>
Pasuritë afatshkurtra			
Llogaritë e arkëtueshme		0	0
Parapagimet			
Paraja dhe ekuivalentët e parashë	3	81.80	15,341.63
Pasuritë tjera afatshkurtra			
<b>Total pasuritë afatshkurtra</b>		<b>81.80</b>	<b>15,341.63</b>
<b>Total pasuritë</b>		<b>81.80</b>	<b>15,341.63</b>
Ekuiteti			
Fondet e akumuluara		81.10	
Suficiti / (deficiti) i vitit		-5,050.00	15,341.63
<b>Total Ekuiteti</b>		<b>-4,968.90</b>	<b>15,341.63</b>
Detyrimet			
Detyrimet afatgjata			
Huatë e pagueshme			
Të hyrat e shtyera			
<b>Gjithsej detyrimet agatgjata</b>		<b>0.00</b>	<b>0.00</b>
Detyrimet afatshkurtra			
Llogaritë e pagueshme dhe të tjera	4	5,050.00	
Huatë e pagueshme			
Detyrimet tjera afatshkurtra	5		
<b>Gjithsej detyrimet afatshkurtra</b>		<b>5,050.00</b>	<b>0.00</b>
<b>Gjithsej detyrimet</b>		<b>5,050.00</b>	<b>0.00</b>
<b>Gjithsej ekuiteti dhe detyrimet</b>		<b>81.10</b>	<b>15,341.63</b>

Kosova Demokratik Turk Partisi

Pasqyrat Financiare te Fushatës

Zgjedhjet e jashtëzakonshme nationale 11 Maj 2017 deri me 11 Qershor 2017

**Pasqyra e të hyrave dhe shpenzimeve**

Për periudhën: 11.05.2017 deri 11.06.2017

	Shënim	Shuma ne Euro
<b>Të hyrat</b>		
Të hyrat nga buxheti		<b>15,854.09</b>
Të hyrat nga anëtarësia		
Donacionet dhe kontributet në të holla	6	<b>5,900.00</b>
Kontributet në natyrë në mall dhe shërbime		
Te hyrat e liruara nga te hyrat e shtyera		
Të hyrat tjera		
<b>Gjithsej të hyrat për vitin</b>		<b>21,754.09</b>
<b>Shpenzimet</b>		
Pagat dhe kompenzimet	2	3,040.00
Shpenzimet e transportit	2	238.73
Reklamat, reprezentacioni dhe konferencat	2	22,979.97
Blerja e mallrave	2	265.39
Shpenzimet e përgjithshme	2	80.00
Shpenzimet e ndryshme	2	200.00
<b>Gjithsej shpenzimet për vitin</b>		<b>26,804.09</b>
<b>Suficiti / (deficiti) për vitin</b>		<b>- 5,050.00</b>

**Kosova Demokratik Turk Partisi**

*Shenimet sqaruese*

*Zgjedhjet e jashtëzakonshme nacionale 11 Maj 2017 deri me 11 Qershor 2017*

---

## **1. Informata te përgjithshme**

Kosova Demokratik Turk Partesi KDTP

E themeluar: 2001

Kryetar : Mahir Jagcilar

Zyrtar finanziar: Sezer Hoti

Selja: Prizren

Pasqyrat financiare te KDTP-së janë përgatitur sipas kërkesave te Ligjit Nr. 04/L-212 për plotësimin dhe ndryshimin e Ligjit Nr. 03/L-174 për financimin e subjekteve politike, të ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr.04/L-058, nen 15 Raportimi Financiar.

Bazuar në nenin 19 paragrafi 2 pikë 7 e Ligjit Nr. 04/L-212 Për plotësimin dhe ndryshimin e Ligjit Nr. 03/L-174 Për financimin e subjekteve politike, të ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr.04/L-058 ,Subjekti i regjistruar politik brenda pesë (5) ditëve të punës nga marrja e draft raporteve të audituara ka dorëzuar raportin e rishikuar financiar dhe shpjegimet lidhur me gabimet ose lëshimet të identifikuara nga auditorët.

Subjekti Politik mirëmban vetëm një llogari te vetme bankare ne bankën: NLB.

**Kosova Demokratik Turk Partisi**

**Shenimet sqaruese**

**Zgjedhjet e jashtëzakonshme nacionale 11 Maj 2017 deri me 11 Qershor 2017**

**Shënim 7. Paraja dhe ekuivalentët e parasë**

	<b>Me 31 Dhjetor 2017 Shuma në Euro</b>	<b>Me 31 Dhjetor 2016 Shuma në Euro</b>
Paraja në bankë	81.1	15,341.63
Paraja në arkë		
<b>Gjithsej paraja dhe ekuivalentët e parasë</b>	<b>81.10</b>	<b>15,341.63</b>

**Shënim 8. Llogaritë e pagueshme dhe të tjera**

	<b>Me 31 Dhjetor 2017 Shuma në Euro</b>	<b>Me 31 Dhjetor 2016 Shuma në Euro</b>
Llogari te pagueshme të tjera	5,050.00	
<b>Gjithsej llogaritë e pagueshme dhe të tjera</b>	<b>5,050.00</b>	<b>0.00</b>

**Shënim 2 . Shpenzimet**

	<b>Shpenzimi</b>	<b>Pagesa</b>	<b>Borxhi i mbetur</b>
<b>Shpenzimet</b>	<b>në Euro</b>	<b>në Euro</b>	<b>në Euro</b>
<b>Pagat dhe kompensimet</b>			
Pagat dhe kompensimet, neto			0.00
Pagesat per vezhgu	3,040.00	3,040.00	0.00
Kontributet pensionale të punëmarrësit			0.00
Kontributet pensionale të punëdhënësit			0.00
Tatimet në të ardhura personale			0.00
Beneficionet tjera			0.00
<b>Gjithsej</b>	<b>3,040.00</b>	<b>3,040.00</b>	<b>0.00</b>
<b>Shpenzimet e transportit</b>			
Automjetet motorike të huazuara			0
Karburantet			0
Biletat, aeroplani/autobusit/trenit/taksit etj.			0
Sigurimi dhe mirëmbajtja e veturave	238.73	238.73	0
Çdo shpenzim tjetër i transportit			0
<b>Gjithsej shpenzimet e transportit</b>	<b>238.73</b>	<b>238.73</b>	<b>0.00</b>

**Kosova Demokratik Turk Partisi**

**Shenimet sqaruese**

**Zgjedhjet e jashtëzakonshme nacionale 11 Maj 2017 deri me 11 Qershor 2017**

<b>Reklamat, reprezentacioni dhe konferencat</b>			
Hapsira,lokale,zyra dhe objekte tjera me qira			0.00
Ushqimi	10,366.25	5,516.25	4,850.00
Aktivitete kulturore dhe rekreative			0.00
Radio dhe spotet televizive	12,613.72	12,613.72	0.00
Stendat e afishmit dhe reklamimet në gazeta			0.00
Shpenzimet tjera të reklamave, reprezentacionit dhe konferencave			0.00
<b>Gjithsej reklamat, reprezentacioni dhe konferencat</b>	<b>22,979.97</b>	<b>18,129.97</b>	<b>4,850.00</b>
<b>Blerja e mallrave</b>			
Furnizimi i zyrës	265.39	265.39	0
Pajisjet të vogla			0
<b>Gjithsej blerja e mallrave</b>	<b>265.39</b>	<b>265.39</b>	<b>0.00</b>
<b>Shpenzimet e përgjithshme</b>			
Telefoni, interneti dhe posta	80.00	80.00	0.00
Rryma, shërbimet komunale (uji dhe mbeturinat)			
Gjoba dhe ndeshkime			0.00
Shpenzimet lidhur me donacionet dhe kontributet ne natyrë në mallra dhe shërbime			0.00
<b>Gjithsej shpenzimet e përgjithshme</b>	<b>80.00</b>	<b>80.00</b>	<b>0.00</b>
<b>Shpenzimet e ndryshme</b>			
Mirëmbajtja e pajisjeve dhe hapësirave të zyrës	0	0	0
Shpenzimet që nuk janë përfshirë në asnjë kategori tjetër	200.00		200.00
<b>Gjithsej shpenzimet e ndryshme</b>	<b>200.00</b>	<b>0.00</b>	<b>200.00</b>
<b>Gjithsej shpenzimet</b>	<b>26,804.09</b>	<b>21,754.09</b>	<b>5,050.00</b>

**Kosova Demokratik Turk Partisi**

*Shenimet sqaruese*

*Zgjedhjet e jashtëzakonshme nacionale 11 Maj 2017 deri me 11 Qershor 2017*

**Shenjimi 3: Donacionet dhe kontributet në të holla**

				Vlera	E pranuar përmes:	
Kontribuesi	Adresa	NR personal	Data	në euro	Bankë	Arkë
Enver Dubovci	D.Kombit 122 Vushtrri		03.06.2017	300.00		300.00
Sencar karamuqo	Alajdin berisha-27		04.06.2017	500.00		500.00
Abdulhadi Krasnic	Mamusha		04.06.2017	500.00		500.00
Cuneyd Ustaibo	B.Kelmendi-35 Prishtine		04.06.2017	300.00		300.00
Abdullah Pirce	Skenderbeu-220-vushtrri		04.06.2017	250.00		250.00
Beyhan Erciyas	Nena Tereza II4-47 Prizren		04.06.2017	500.00		500.00
Edis Kogjashli	Sheshi I lidhjes 66/7-Prizren		04.06.2017	450.00		450.00
Mahir Yagcilar	R.ukimeri I/3		04.06.2017	500.00		500.00
Ebru Zborca	Sadik Zeneli IA		04.06.2017	300.00		300.00
Ertan Simitci	Beteja e Llapushnikut 7/1		05.06.2017	500.00		500.00
Recep Rada	M.Sharri-3		06.06.2017	500.00		500.00
Fikrim Damka	Adriatik 9-Prizren		06.06.2017	500.00		500.00
Arzu Virsevca	Mbreti Pirro NR.7		07.06.2017	400.00		400.00
Sezer Hoti	Rifat ukimeri 17		07.06.2017	400.00		400.00
				5,900.00	0	5,900.00

Numri personal i donatorit është i njohur për auditorin dhe KQZ-ën, por sipas Ligjit Nr. 03/L-172 për mbrojtjen e të dhënavë personale nuk paraqitet në shënimin nr. 3 për publikun